

VENDIM
Nr. 188, datë 2.4.2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.199, DATË 11.1.2012, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MASËN E FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT
TË PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË QË HYJNË
PËR HERË TË PARË NË PUNË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 dhe 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.199, datë 11.1.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titullin e vendimit, fjalët “... që hyjnë për herë të parë në punë ...” zëvendësohen me “... të rinj ...”.

2. Kudo në vendim, emërtimet “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe “Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës” zëvendësohen përkatësisht me “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë...” dhe “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

3. Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

“1. Përfitues të këtij programi janë punëkërkues të rinj nga mosha 16-30 vjeç. Zyra përkatëse e punësimit financon:

a) punëdhënësin, me një financim mujor në masën deri në 100 për qind të kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore (pjesë e kontributit të punëdhënësit), me kusht që kohëzgjatja e kontratës së punës të mos jetë më e shkurtër se një vit. Ky financim bëhet nga zyra e punësimit në drejtorinë rajonale të sigurimeve shoqërore, sipas procedurave përkatëse;

b) punëmarrësin e përfshirë sipas këtij programi, me katër paga në masën 100 për qind të pagës minimale në shkallë vendi, në muajt e pestë e të gjashtë dhe në muajt e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës, ndërsa për muajt e tjerë financon punëdhënësi.

Punëdhënësit, persona juridikë apo fizikë, kanë të drejtë të kërkojnë të përfshijnë në program:

i) deri në 100 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë deri në 50 punonjës;

ii) deri në 50 për qind të numrit aktual mesatar të të siguruarve në tre muajt e fundit, në rast se kanë mbi 50 punonjës.”.

4. Në fund të pikës 2 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje

“Publikimi i programit bëhet, gjithashtu, me të gjitha mjetet e mundshme elektronike dhe joelektronike.”

5. Në pikën 3 hiqen fjalët “... verifikuar nga Inspektorati i Punës ...”.

6. Në pikën 4 bëhen këto shtesa:

a) Në përmbajtjen e shkronjave “a” dhe “d” pas fjalës “... juridik ...” shtohen “... dhe fizik ...”.

b) Në fund të nënndarjes “v”, të shkronjës “dh” shtohet nënndarja “vi”, me këtë përmbajtje:

“vi. akte të inspektimit në punë, të kryera nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.”.

7. Pika 6 riformulohet, si më poshtë vijon:

“6. Punëdhënësit mund të aplikojnë për programin në mënyrë elektronike apo pranë zyrave të punësimit.”.

8. Në pikën 10, pas fjalës “... organizimit ...” shtohen fjalët “... vlerësimit të projekteve ...”.

9. Pika 11 riformulohet, si më poshtë vijon:

“11. Komisionet e miratimit të projekteve në zyrën rajonale të punësimit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Kombëtar të Punësimit vendosin miratimin ose jo të projektit brenda 10 (dhjetë) ditëve pune.”.

10. Në pikën 17 hiqen fjalët “... në bashkëpunim me inspektoratin rajonal/vendor të punës ...”.

11. Në pikën 18, pas fjalës “... punëdhënësi ...” hiqen “... dhe vlerësimit të Inspektoratit të Punës për shkaqet e zgjidhjes së kontratës ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

